



Zgjedhjet - Izbori - Elections
2007

Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

MONITORIMI I MEDIAVE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE NË KOSOVË (26 TETOR - 16 NËNTOR 2007)



Koha Ditore
Zëri
Lajm
Express
Info Press
Epoka e re

Radio Televizioni i Kosovës (RTK)
Koha Vision (KTV)
Radio Televizioni 21 (RTV 21)

Radio Kosova
Radio Dukagjini

Prishtinë, shkurt 2008





Demokracia në Veprim
Zgjedhjet 2007



MONITORIMI I MEDIAVE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE NË KOSOVË

**PERIUDHA E MONITORIMIT:
(26 TETOR - 16 NËNTOR 2007)**

Prishtinë,
Shkurt 2008

Monitorimi i mediave (26 tetor – 16 nëntor)

Monitorimi i mediave dhe përpilimi i këtij raporti është realizuar në kuadër të koalicionit të OJQ-ve “Demokracia në Veprim”. Ky projekt është përkrahur nga USAID, IFES, dhe NDI. Prezantimi i këtij punimi është bërë i mundur edhe me ndihmën e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Përgatitur nga: Arif Muharremi dhe Leon Malazogu

Redaktuar nga: Leon Malazogu dhe Valmir Ismaili

Falenderime të veçanta shkojnë për Boris Darmanović nga Mali i Zi që ka ndihmuar metodologjikisht në disenjimin e monitorimit. Gjithashtu falenderohen të gjithë monitoruesit e mediave për punë neutrale dhe të palodhshme.

Copyright © 2008 KIPRED. Të gjitha të drejtat e riprodhimit janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet, të ruhet në sisteme ripërtrisëse ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjet elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, etj., pa lejen me shkrim të autorit. Pjesë të shkurtra të tekstit, që nuk kalojnë dy paragrafa, mund të citohen pa lejen eksplicite të dhënë nga autori me kusht që të jepet i tërë burimi nga është marrë teksti. Luteni të kontaktoni: info@kipred.net apo +381 38 555 887.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Kodra e Diellit, Rruga 3, Lam. 39
Prishtinë, Kosovë (UNMIK)
Telefon dhe faks: +381 38 555 887
www.kipred.net
www.democracy2007.net

Përmbledhje

Shumica prej raporteve të mediave të monitoruara gjatë fushatës së zgjedhjeve janë përpjekur ti pëmbahen kodit gazetaresk të mirësjelljes, derisa në anën tjetër kjo nuk do të thotë se kanë qenë të balancuara në aspektin sasior (kohë\hapësirë) dhënë subjekteve dhe zyrtarëve partiakë.

Pothuajse nga të gjitha mediat, partia më e mbuluar ka qenë PDK-ja, ndërsa rëndësi më së paku i është kushtuar LDD-së. Në shumicën e mediave PDK-ja ka marrë kontekstin më të madh pozitiv. LDK dhe AKR kanë marrë shumicën e paraqitjeve me kontekst negativ në shumicën prej mediave. Në shumicën e rasteve mediat i kanë favorizuar Hashim Thaçin dhe Veton Surroin duke i prezantuar ata pozitivisht. Në anën tjetër Fatmir Sejdiu dhe Behgjet Pacolli kanë qenë të paraqitur në prezantim më negativ.

Shumica dërmuese e mediave janë përmbajtjet nga animet gjatë mbulimit medial të fushatave të subjekteve politike, derisa një numër i vogël i tyre ka dështuar që të jenë objektive në raportimin e fushatave duke e vazhduar traditën e përkrahjes së një subjekti politik. Kodi i mirësjelljes kryesisht është përcjellur ndërsa poashtu gjuha e përdorur në raporte ka qenë e matur.

Gjuha me të cilën mediat kanë raportuar fushatat e subjekteve politike nuk ka qenë e ashpër apo nxitëse derisa shumica e mediave kanë performuar një gazetari të paanshme por gjithmonë me prioritetin e prezantimit të partive kryesore politike. Përgjithësisht raportet mediale në Kosovë gjatë zgjedhjeve kanë krijuar një klimë demokratike ku shumica prej tyre kanë ndarë apo kanë tentuar të ndajnë një hapësirë të barabartë për zyrtarët dhe subjektet kryesore politike në vend ndërsa po ashtu janë përpjekur që ti prezantojnë në mënyrë sa më neutrale.

Disa nga mediat e shkruara (*Lajm*, *InfoPress*) kanë shfaqur një gazetari jo të balancuar duke iu dhënë prioritet subjekteve të caktuara politike, ndërsa gjuha e përdorur në raportet e këtyre mediave nuk ka qenë për të dëmtuar apo nxitur urrejtje ndaj partive rivale sa për të glorifikuar zyrtarët e caktuar të partive ndaj të cilave kanë treguar mbështetje.

Disa prej mediave të tjera kanë mbështetur një subjekt të caktuar politik në rastin e shkëmbimit të akuzave me një subjekt tjetër politik (*Koha Ditore*\KTV karshi Surroit) ndërsa disa media të tjera i janë vënë në mbrojtje subjektit të akuzuar duke e paraqitur atë të pafajshëm përballë këtyre akuzave (*Lajm* karshi Pacollit).

Në shumicën e herave, këto raste sjellin në dyshim pavarësinë financiare dhe politike të mediave, ndërsa i njëjti rast është edhe me *Lajm* dhe *InfoPress* të cilat kanë shfaqur një lloj varësie ndaj subjekteve të caktuara politike. Kjo varësi ka rezultuar me raportim të jo të balancuar për të gjitha subjektet ndërsa në këtë mënyrë edhe i është shmangur kodit gazetaresk të mirësjelljes.

Gjatë fushatës kanë qenë një seri ngjarjesh të cilat kanë shënuar kthesa edhe në reagimin e subjekteve të ndryshme dhe në gjuhën e raportimeve të mediave: rritja e pensioneve nga qeveria, intervista e Pacollit në Zërin e Amerikës, shfrytëzimi i automjeteve zyrtare në fushata, etj.

Mediat elektronike, e veçmas televizioni publik, kanë treguar një pjekuri më të madhe në përfaqësimin e balancuar të kandidatëve femra dhe të subjekteve minoritare si në raportet e rubrikave të lajmeve e po ashtu edhe në debate. Mediumet publike gjithashtu ju kanë dhënë hapësirën më të madhe subjekteve të pakicave.

Përmbajtja:

Përmbledhje	3
Hyrje	5
Mediat e monitoruara.....	5
Metodologjia.....	6
Koha Ditore.....	7
Zëri.....	11
Lajm.....	15
Express.....	19
Info Press	22
Epoka e re	26
Radio Televizioni i Kosovës (RTK)	29
Koha Vision (KTV)	33
Radio Televizioni 21 (RTV 21)	36
Radio Kosova.....	39
Radio Dukagjini	42
Prezantimi gjinor.....	45
Partitë e pakicave	46

Hyrje

Ky raport paraqet rezultatet e monitorimit të mediave gjatë fushatës zgjedhore nga 26 tetori deri më 16 nëntor të vitit 2007. Monitorimi i raportimit të mediave është realizuar si pjesë e projektit për vëzhgim të zgjedhjeve, në kuadër të koalicionit të OJQ-ve “Demokracia në Veprim – Zgjedhjet 2007”.

Pjesa e parë paraqet mediat që janë monitoruar dhe në vazhdim shpjegon metodologjinë e përdorur. Pjesa më e madhe e raportit i dedikohet analizave individuale për secilin medium në veçanti. Pastaj, punimi krahason raportimin e medimeve sa i përket hapësirës së dedikuar ndaj subjekteve, liderëve, kandidatëve femra, etj.

Mediat e monitoruara

Monitorimi ka mbuluar tri televizionet kombëtare, gjashtë gazeta ditore, si dhe dy radio me frekuenca kombëtare.

Mediat elektronike:

RTK – Televizioni Publik i Kosovës
KTV – Televizion privat me shtrirje kombëtare
RTV 21 – Televizion privat me shtrirje kombëtare
Radio Kosova – Radio publike me shtrirje kombëtare
Radio Dukagjini – Radio private me shtrirje kombëtare

Televizionet dhe radiot janë monitoruar gjatë kohës së shikueshmërisë së lartë:

Nga ora 07:00 - 09:30 e mëngjesit – ku janë përfshirë lajmet më të reja mbi fushatat e subjekteve politike dhe zyrtarët partikë të ftuar si mysafirë në programet televizive.

Nga ora 17:00 - 23:00 e mbrëmjes – ku janë përfshirë edicionet e lajmeve, përfshirë edhe atë qëndror dhe debatet me zyrtarët partiakë.

Gazetat e përditshme

Koha Ditore, Zëri, Lajm, Express, InfoPress, dhe Epoka e re.

Raporti ka analizuar mediat duke matur:

- a) paraqitjen gazetareske të kandidatëve partiakë (prezantimi),
- b) kontekstin në të cilin pasqyrohet veprimtaria zgjedhore (konteksti),
- c) kohën/hapësirën e cila u është dhënë subjekteve dhe zyrtarëve politikë (hapësira/koha),
- d) raportimin për aktivitetet e partive minoritare, dhe
- e) përfaqësimin e femrave në subjektet partiake.

Projekti i monitorimit të mediave gjatë fushatës zgjedhore ka mbuluar mediat elektronike dhe të shtypura, të përzgjedhura në bazë të kriterit të shtrirjes kombëtare, shitjes, lexueshmërisë, shikueshmërisë, dëgjueshmërisë dhe ndikimit në audiencën mediale. Për shkak të kufizimeve buxhetore nuk janë vëzhguar të gjitha gazetatat ditore.

Metodologjia

E përbërë nga 10 monitorues, ekipi për monitorimin e mediave ka përcjellë mediat gjatë fushatës së zgjedhjeve me qëllim të vlerësimit:

- Nëse partive politike dhe kandidatëve u është dhënë hapësirë korrekte në media;
- Nëse partitë politike dhe kandidatët janë përcjellë në mënyrë të paanshme dhe të barabartë; dhe
- Nëse ka qenë e mundur për publikun që të informohet sa duhet nëpërmjet mediave për të marrë një vendim në ditën e zgjedhjeve.

Përmbajtja e mediumeve – lajme, raporte, editoriale dhe kolumne, debate, klipe, reklama partiake – është vlerësuar duke matur:

kohën\hapësirën e cila u është kushtuar partive dhe kandidatëve;

kontekstin në të cilin janë paraqitur ata;

prezantimin për partitë dhe kandidatët dhe replikat\vërejtjet që u janë dhënë atyre nga ndonjë subjekt tjetër.

Përderisa sasia mat hapësirën e dedikuar një subjekti apo individ, dy kategoritë tjera masin çdo paraqitje në aspektin cilësor, duke i vlerësuar ato si pozitive, negative apo neutrale.

Metoda Sasiore: Hapësira Mediale

Metoda sasiore mat kohën (mediat elektronike transmetuese) apo hapësirën (mediat e shkruara), e paraqitur në sekonda apo cm² respektivisht. Hapësira nënkupton kohën apo hapësirën në të cilën një parti politike apo zyrtar partiak është përmendur, ka folur, është cituar apo është paraqitur në ekran.

Metoda Cilësore: Konteksti dhe Prezantimi

Matja e sasisë kohore të dedikuar një subjekti nuk mjafton për të vlerësuar balancin medial. Një subjekt mund të gëzojë hapësirë të madhe mirëpo kjo të jetë kryesisht negative. Rrjedhimisht, monitorimi ka matur edhe cilësinë e kësaj hapësire, të shprehur në negative apo pozitive.

Duke analizuar kontekstin dhe mënyrën e prezantimit, monitorimi i mediave ka vlerësuar nëse raportimi medial ka anuar për ose kundër partive apo zyrtarëve partiakë.

Konteksti është animi i informacionit nga konteksti i ngjarjes pa qenë i ndikuar shprehimisht nga gazetari. Konteksti mund të jetë pozitiv, negativ apo neutral.

Prezantimi do të thotë ndikimi i gazetarit apo medias në mënyrën si paraqet një informatë të caktuar. Kjo kategori vlerëson gjuhën e përdorur nga media\gazetari ndaj një partie apo zyrtari partiak. Disa nga format gazetareske si komentet apo analizat e lajmeve janë të lejuara, për dallim nga disa të tjera si ndërthurja e komentit me lajm, mungesa e informatave të caktuara apo efekte të ngjashme negative. Paraqitja gazetareske mund të jetë pozitive, negative apo neutrale.

Të dhënat janë prezantuar kryesisht në mënyrë vizuale. Ndonjëherë, të dhënat më pak të rëndësishme vetëm janë përmbledhur në tekst.


“Demokracia në Veprim” fatkeqësisht nuk ka arritur që të bëjë krahasimin me monitorimin e mediave të zgjedhjeve të kaluara meqë nuk e ka bërë atë proces, por me siguri monitorimi i zgjedhjeve 2007 do të jetë një pikënisje e mirë për analizën e raportimit të mediave gjatë fushatave të ardhshme zgjedhore.

Koha Ditore


- Hyrje Gazetë e përditshme, pronë e grupit medial 'Koha'. Ka lidhje të ngushta me kreun e ORA-s, i cili ka qenë pronar i gazetës para krijimit të partisë.
- Vlerësim i përgjithshëm *Koha Ditore* ka pasur një raportim kryesisht të balancuar të fushatave të subjekteve politike.
- Vërehet një tendencë e përkrahjes së zyrtarëve të ORA-s. *Koha Ditore* ka paraqitur në kontekst negativ kryetarin e AKR-së, Behgjet Pacollin, dhe partitë LDK e AAK.
- PDK ka gëzuar hapësirën më të madhe në *Koha Ditore*, duke u pasuar nga ORA. LDK ka qenë e treta për nga hapësira por e para për nga prezantimi dhe konteksti negativ.
- Pro ORA, PDK
- Kundër Koalicionit qeverisës (LDK, AAK) dhe AKR-së
- Neutral LDD
- Partitë e vogla Hapësirë e kënaqshme dhe e balancuar.
- Pakicat Hapësirë e kënaqshme dhe prezantim neutral.
- Balanci gjinor Raportimi i femrave në *Koha Ditore* ka qenë mesatar krahasuar me mediumet e tjera të shkruara. Dominojnë kandidatet e partisë ORA, përderisa raportimi për kandidatet e partive tjera ka qenë i balancuar.
- Fokusi individual Hashim Thaçi, Behgjet Pacolli dhe Veton Surroi kanë gëzuar vëmendjen kryesore në *Koha Ditore* si për nga hapësira ashtu edhe për nga paraqitja pozitive. Prezantimi i gazetarëve ka qenë më pozitiv për Veton Surroin dhe Hashim Thaçin ndërsa negativ për Behgjet Pacollin.

Partitë e mëdha

Në hapësirën dhënë partive të mëdha në *Koha Ditore* ka dominuar PDK. Më së paku hapësirë ka pasur LDD.




Konteksti



Në kontekstin më pozitiv në *Koha Ditore* është përmendur PDK. Në kontekstin më negativ është përmendur LDK.

Prezantimi


Gazetarët kanë paraqitur më pozitivisht PDK-në dhe ORA-n. Prezantimin më negativ gazetaresk e ka LDK. ORA është subjekti i vetëm që nuk është prezantuar negativisht.




Subjektet tjera

Koha Ditore ka qenë e balancuar dhe neutrale në paraqitje të subjekteve të vogla. Kjo gazetë nuk ka shfaqur anime apo gjuhë negative për asnjërën nga partitë e vogla.

Hapësira - partitë e vogla



Hapësira - subjektet minoritare




Hapësira më e madhe sa i përket partive minoritare në *Koha Ditore* i është dhënë PDAK-së e cila po ashtu është paraqitur në kontekstin më pozitiv. Partitë minoritare kryesisht janë mbuluar në mënyrë të balancuar dhe paraqitur në mënyrë neutrale.

Udhëheqësit kryesorë


Hapësirën më të madhe në *Koha Ditore* e kanë ndarë Hashim Thaçi, Behgjet Pacolli dhe Veton Surroi. Më së paku hapësirë i është kushtuar Fatmir Sejdiut dhe Ramush Haradinajt.

Hapësira




Konteksti

Kontekstin më pozitiv në *Koha Ditore* e kanë ndarë Veton Surroi dhe Behgjet Pacolli i cili po ashtu është paraqitur në kontekstin më negativ për shkak të reagimeve të subjekteve politike në media ndaj një interviste të tij.



Prezantimi



Gazetarët kanë prezantuar në mënyrë më pozitive Hashim Thaçin dhe Veton Surroin, ndërsa negativisht janë paraqitur Behgjet Pacolli dhe Fatmir Sejdiu.


Zëri

- Hyrje Gazeta *Zëri* botohet si vazhdimësi e javores *Zëri*. Gazeta udhëhiqet nga Blerim Shala, koordinator i Ekipit të Unitetit gjatë procesit të negociatave.
- Vlerësim i përgjithshëm *Zëri* ka raportuar mbi fushatën në mënyrë mjaft neutrale, duke mbajtur një vijë paksa pro-institucional pa raportime kritike. LDK ka marrë hapësirën më të madhe në *Zëri* ndërsa AKR-së i është dhënë hapësira më e vogël. Prezantimi më pozitiv i është dhënë subjekteve PDK, LDK dhe AAK.
- Pro *Zëri* ka shfaqur tendencë të animimit të lehtë ndaj LDK-së dhe AAK-së.
- Kundër *Zëri* nuk ka qenë kundër ndonjë subjekti politik.
- Neutral Ndaj subjekteve tjera.
- Partitë e vogla Balancuar.
- Minoritetet *Zëri* ka mbuluar mesatarisht aktivitetet e partive minoritare dhe i ka paraqitur në mënyrë të balancuar. Hapësirën më të madhe e ka pasur KDTP.
- Balanci gjinor Vetëm 6% të raporteve u janë përkushtuar kandidatëve femra. Raportimi për to ka qenë i balancuar dhe neutral.
- Fokusi individual Hapësira më e madhe prej udhëheqësve kryesorë iu ka dhënë Behgjet Pacollit dhe Hashim Thaçit, të parit në kontekstin më negativ, ndërsa të dytit në atë më pozitiv. Prezantimi më pozitiv i është dhënë Hashim Thaçit dhe çuditërisht Behgjet Pacollit i cilin prin si për anim negativ ashtu edhe për pozitiv.


Hapësira

Partitë e mëdha

Hapësirën më të madhe prej partive të mëdha në *Zëri* e ka pasur LDK. Më së paku hapësirë u është kushtuar AKR-së dhe LDD-së.




Konteksti



Paraqitjet e LDK-së në *Zëri* kanë qenë njëkohësisht më pozitivet dhe më negativet.

Prezantimi


Prezantimin më pozitiv gazetaresk në *Zëri* e ka pasur PDK.



Subjektet tjera


Hapësira - partitë e vogla

Konteksti i partive të vogla në Zëri ka qenë pozitiv për të gjitha partitë.
Prezantimi i partive të vogla në Zëri ka qenë neutral për të gjitha partitë.




Hapësira - subjektet minoritare

Në Zëri, KDTP-ja ka gëzuar hapësirë jashtëzakonisht të madhe në krahasim me partitë tjera të subjekteve pakicë.





Konteksti

Paraqitja e subjekteve minoritare ka qenë kryesisht neutrale dhe e balancuar.




Kandidatët kryesorë

Hapësira më e madhe i është dhënë Behgjet Pacollit, ndërsa hapësira më e vogël Nexhat Dacit.



Në kontekstin më pozitiv në *Zëri* është paraqitur Hashim Thaçi, ndërsa në atë negativ Behgjet Pacolli.

Prezantimi i kandidatëve kryesorë në *Zëri* është kryesisht neutral, derisa më pozitivë janë paraqitur Pacolli (AKR) dhe Thaçi (PDK).




Lajm

- Hyrje *Lajm* është pjesë e ATV Media Group, pronë e kreut të AKR-së, Behgjet Pacollit.
- Vlerësim i përgjithshëm Gazeta *Lajm* ka treguar një anim të dukshëm ndaj partisë AKR të Pacollit. Kjo është vërejtur dukshëm në hapësirën e dhënë zyrtarëve të kësaj partie gjatës fushatës, në fotografi dhe ballinë. AAK gjithashtu ka gëzuar hapësirë, kontekst pozitiv dhe prezantim pozitiv. Hapësira më e vogël në *Lajm* është dhënë partisë ORA.
- Pro AKR, AAK
- Kundër LDK, ORA
- Neutral Partitë e tjera
- Partitë e vogla *Lajm* ka prezantuar në mënyrë të balancuar dhe neutrale partitë e vogla.
- Minoritetet Kjo gazetë ka mbuluar aktivitetet e vetëm dy partive minoritare, në mënyrë neutrale dhe të balancuar.
- Balanci gjinor *Lajm* ka paraqitur numrin më të vogël të kandidatëve femra nga të gjitha mediat e shtypura.
- Fokusi individual Behxhet Pacollit i është dhënë hapësira më e madhe, konteksti dhe prezantimi më pozitiv. Në të njëjtën kohë Pacolli dhe Sejdiu ndajnë numrin e njëjtë të paraqitjeve me kontekst negativ për shkak të sulmeve të subjekteve të partive të ndryshme bërë këtyre zyrtarëve.

Partitë e mëdha


Hapësira

Hapësira më e madhe e partive të mëdha në *Lajm* është dhënë AKR-së. Hapësira me e vogël i është dhënë partive LDD dhe ORA.



Konteksti


Numri i paraqitjeve



Konteksti dhënë partive të mëdha në *Lajm* ka ndryshuar. Në kontekst më pozitiv është paraqitur AKR-ja ndërsa në kontekst më negativ është paraqitur LDK-ja.

Prezantimi


Paraqitja gazetareske në *Lajm* tregon se AKR-ja ka marrë përkrahje më pozitive nga politika redaktuese e gazetës, përderisa LDK-ja atë më negative.




Hapësira

Partitë e vogla

Nga partitë e vogla në *Lajm* hapësira më e madhe i është dhënë PD-së.




Konteksti



Konteksti i partive të vogla në *Lajm* kryesisht është i balancuar.


Prezantimi

Prezantimi gazetaresk i partive të vogla në *Lajm* ka qenë neutral.



Hapësira

cm2




Partitë minoritare


Lajmi ka mbuluar pak aktivitete të subjekteve pakicë, dhe atë vetëm të dy prej sosh. Raportimi ka qenë pozitiv, dhe paraqitja gazetareske neutrale.

Hapësira

Hapësira më e madhe dhënë kandidatëve kryesorë në *Lajm* ka qenë për Behgjet Pacollin, përderisa më e vogla ka qenë për Ramush Haradinaj dhe Nexhat Dacin.




Konteksti



Nga kandidatët kryesorë, kontekstin më pozitiv në *Lajm* e ka marrë Behgjet Pacolli, ndërsa kontekstin më negativ Pacolli dhe Fatmir Sejdiu.

Prezantimin më pozitiv gazetaresk në *Lajm* e ka pasur Behgjet Pacolli, ndërsa prezantimin më negativ e ka pasur Fatmir Sejdiu dhe Veton Surroi.



Prezantimi


Express

- Hyrje Gazeta *Express* botohet nga Media Works, që është pronë e kompanisë IPKO.
- Vlerësim i përgjithshëm *Express* ka treguar një gazetari agresive gjatë raportimeve të fushatës zgjedhore, por duke iu përmbajtur kodit të mirësjelljes. Kjo gazetë kryesisht i ka dhënë hapësirë krerëve të subjekteve politike. Hapësira më e madhe i është dhënë PDK-së, derisa më së paku LDD-së. LDK-ja dhe PDK-ja janë paraqitur në kontekstin më pozitiv, ndërsa të gjitha partitë tjera, me përjashtim të ORA-s janë paraqitur në kontekst negativ. Prezantimi i PDK-së dhe ORA-s ka qenë më pozitiv.
- Pro PDK
- Kundër LDK
- Neutral Të gjitha partitë e tjera
- Partitë e vogla *Express* ka raportuar mesatarisht për partitë e vogla të cilat janë paraqitur në mënyrë të balancuar.
- Minoritetet *Express* ka treguar një hapësirë mesatarisht të kufizuar për partitë minoritare të cilat i ka paraqitur në mënyrë të balancuar dhe neutrale.
- Balanci gjinor *Express* ka qenë ndër mediumet që kanë raportuar më pak për kandidatet femra.
- Fokusi individual Hapësira më e madhe i është dhënë Hashim Thaçit, i cili gjithashtu prin në kontekstin dhe prezantimin pozitiv. Hapësira më e vogël i është dhënë Ramush Haradinajt. Në kontekst më negativ është paraqitur Behxhet Pacolli.


Hapësira

Partitë e mëdha

Hapësira më e madhe në *Express* i ka takuar PDK-së, përderisa më e vogla LDD-së.




Konteksti




Në kontekst më pozitiv në gazetën *Express* janë përmendur PDK dhe LDK, kjo e dyta edhe në kontekst negativ.

Prezantimi

Në prezantim më pozitiv nga partitë e mëdha është paraqitur PDK-ja. LDK-ja është paraqitur në mënyrën më negative.



Partitë e vogla




Hapësira


Hapësirën më të madhe prej partive të vogla në *Express* e ka pasur PD-ja. Konteksti i partive të vogla në *Express* ka qenë pozitiv, përderisa paraqitja gazetareske e partive të vogla ka qenë neutrale.

Partitë minoritare

Hapësirën më të madhe prej partive minoritare në *Express* e ka pasur VAKAT. Konteksti i partive minoritare në *Express* ka qenë pozitiv për të gjitha partitë, dhe prezantimi gazetaresk neutral.



Hapësira




Hapësira

Zyrtarët kryesorë

Nga kandidatët kryesorë në *Express* më së shumti hapësirë ka marrë Hashim Thaçi, përderisa më së paku Ramush Haradinaj.

Si dhe në shumicën e mediave tjera, Behgjet Pacolli është paraqitur në kontekstin më

negativ, ndërsa Hashim Thaçi në atë më pozitiv. Behgjet Pacolli ka marrë prezantimin më negativ, ndërsa Pacolli dhe Thaçi ndajnë shkallën më të lartë të prezantimit gazetaresk pozitiv.



Konteksti

■ negativ
■ neutral
■ pozitiv


Info Press

- Hyrje Drejtori i gazetës, Rexhep Hoti, ka qenë kandidat i PDK-së në zgjedhjet e përgjithshme.
- Vlerësim i përgjithshëm *InfoPress* ka qenë njëra prej dy gazetave me më së shumti anim në raportimin e fushatave të subjekteve partiake, ndërsa i ka dhënë përparësi PDK-së në rrafshin e hapësirës së dhënë, imazheve dhe gjuhës së përdorur nga gazetarët, e sidomos për kryetarin e partisë, Thaçi. PDK-së i është dhënë shumica dërrmuese e hapësirës si dhe konteksti dhe prezantimi më pozitiv. Hapësira më e vogël i është dhënë ORA-s. LDK-ja dhe AKR-ja janë paraqitur në kontekst më negativ. LDK-ja është paraqitur në prezantim më negativ.
- Pro PDK
- Kundër LDK
- Neutral Të gjitha partitë tjera
- Partitë e vogla *InfoPress* ka dhënë një hapësirë të kënaqshme për partitë e vogla konkurruese me një prezantim të balancuar gazetaresk
- Minoritetet *InfoPress* ka dhënë një hapësirë të vogël partive minoritare.
- Balanci gjinor *InfoPress* ka treguar një mbulim të kënaqshëm të femrave kandidate, duke i veçuar ato të PDK-së (Çitaku), në krahasim me mediat e tjera të shkruara.
- Fokusi individual Hashim Thaçi i është dhënë hapësira më e madhe, konteksti dhe prezantimi më pozitiv. Ramush Haradinajt i është dhënë hapësira më e vogël. Behgjet Pacolli është paraqitur në kontekst më të madh negativ.


Hapësira

Partitë e mëdha

Nga partitë e mëdha, hapësirën me të madhe *Info Press* ia ka dhënë PDK-së.




Konteksti



Kontekstin më pozitiv e ka pasur PDK-ja, derisa LDK-ja dhe AKR-ja kanë pasur kontekstin më negativ.


Prezantimi

Prezantimin më pozitiv gazetaresk në *Info Press* e ka marrë PDK-ja, përderisa atë më negativ LDK-ja.




Partitë e vogla

Ngjashëm si në mediumet tjera, hapësirën më të madhe prej partive të vogla në *Info Press* e ka marrë PD-ja.




Konteksti




Konteksti i dhënë partive të vogla në *InfoPress* kryesisht ka qenë pozitiv. LKÇK-ja ka pasur një paraqitje me kontekst negativ. Prezantimi për tri partitë e vogla në *InfoPress* ka qenë neutral.

Partitë minoritare

Hapësirën më të madhe prej partive minoritare në *Info Press* e ka marrë PDAK, ndërsa atë më të voglën SDA.




Konteksti




Konteksti më pozitiv i dhënë partive minoritare i takon koalicionit VAKAT. Asnjë parti minoritare nuk është paraqitur me kontekst negativ.

Info Press kryesisht ka paraqitur partitë minoritare në mënyrë neutrale, dhe nuk ka treguar prezantim negativ gazetaresk për asnjërën nga partitë.

Zyrtarët kryesorë




Kontekstin më pozitiv prej zyrtarëve kryesorë në *Info Press* e ka marrë Hashim Thaçi,




ndërsa më negativin Behxhet Pacolli.

Prezantimi



Prezantimi më pozitiv prej zyrtarëve kryesorë në *InfoPress* i është dhënë Hashim Thaçit. Prezantimi më negativ i është dhënë Behgjet Pacollit.



Hapësirën më të madhe në *Info Press* e ka pasë kreu i PDK-së, Hashim Thaçi, përdërisa me të voglën kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj.


Epoka e re

- Hyrje *Epoka e Re* botohet nga Muhamet Mavraj, i cili është edhe themelues i kësaj gazete. Konsiderohet e afërt me PDK-në por mban qëndrim mjaft kritik në përgjithësi.
- Vlerësim i përgjithshëm *Epoka e re* ka treguar një gazetari të balancuar gjatë raportimit të fushatave të subjekteve politike. *Epoka e re* ka bërë një ndarje të barabartë të hapësirës së vet, përfshirë ballinën dhe për të gjithë subjektet e mëdha konkurruese politike. Përveç PDK-së, *Epoka e re* nuk ka përkrahur dukshëm ndonjërin prej subjekteve tjera. Kjo gazetë ka dhënë hapësirë të kënaqshme secilës prej këtyre subjekteve politike. Hapësira më e vogël i është dhënë LDD-së.
- Pro PDK. Hapësira më e madhe i është dhënë PDK-së, gjithashtu edhe konteksti dhe prezantimi më pozitiv.
- Kundër Konteksti dhe prezantimi më negativ i është dhënë LDK-së.
- Neutral Të gjitha partitë.
- Partitë e vogla Kjo gazetë ka dhënë hapësirën e duhur partive të vogla gjatë fushatave të tyre ndërsa ka treguar një gazetari të balancuar gjatë mbulimit të tyre.
- Minoritetet *Epoka e re* ka dhënë një hapësirë të madhe për subjektet politike minoritare duke prezantuar një spektër të madh prej tyre. Konteksti dhe prezantimi gazetaresk për këto parti është kryesisht pozitiv dhe i balancuar
- Balanci gjinor Balanci gjinor në *Epoka e re* është kryesisht i prezantuar në kontekst pozitiv dhe prezantim gazetaresk neutral. Kjo gazetë ka dhënë një hapësirë të gjerë për kandidatet femra të subjekteve politike.
- Fokusi individual Hapësira më e madhe i është dhënë Behgjet Pacollit, ndërsa më e vogla Fatmir Sejdiut. Konteksti më pozitiv u është dhënë Behgjet Pacollit dhe Hashim Thaçit ndërsa më negativ Fatmir Sejdiut. Prezantimi më pozitiv i është dhënë Hashim Thaçit ndërsa ai më negativ Fatmir Sejdiut.


Partitë e mëdha

Hapësira më e madhe në *Epoka e re* i është dhënë PDK-së, përderisa hapësirën më të vogël e ka pasë LDK.

Konteksti




Konteksti




Konteksti më pozitiv nga partitë e mëdha në *Epoka e re* i është dhënë PDK-së, përderisa konteksti më negativ LDK-së.

Prezantimi

Prezantimi më pozitiv në *Epoka e re* i është dhënë PDK-së dhe AAK-së, përderisa ai më negativ LDK-së.



Hapësira




cm2 Partitë e vogla


Hapësirën më të madhe prej partive të vogla në *Epoka e re* e ka marrë PD-ja.

Konteksti

Konteksti për partitë e vogla në *Epoka e re* ka qenë pozitiv. Paraqitja gazetareske e partive të vogla në *Epoka e re* ka qenë neutrale për të gjitha partitë.



Hapësira




Partitë minoritare


Konteksti i dhënë partive minoritare në *Epoka e re* ka qenë përgjithësisht pozitiv dhe prezantimi neutral.

Zyrtarët kryesorë

Hapësira më e madhe dhënë zyrtarëve kryesorë në *Epoka e re* ka qenë për Behgjet Pacollin. Hapësirën më të vogël në *Epoka e re* e ka pasur Fatmir Sejdiu.



Konteksti



Kontekstin dhe prezantimin më pozitiv e kanë pasur Behgjet Pacolli dhe Hashim Thaçi. Në të dy kategoritë Fatmir Sejdiu është paraqitur negativisht.

Radio Televizioni i Kosovës (RTK)

Hyrje Televizion publik

Vlerësim i përgjithshëm *RTK* ka raportuar kryesisht në mënyrë të balancuar. Hapësira më e madhe dhe konteksti më pozitiv i është dhënë PDK-së ndërsa ajo më e vogla LDD-së. Prezantimi më pozitiv i është dhënë PDK-së.

Pro Televizioni publik ka shfaqur në dritë pozitive PDK-në dhe kandidatin kryesor të kësaj partie, Thaçin.

Kundër Qeveria

Neutral Partitë e tjera

Partitë e vogla *RTK* gjithashtu është treguar mjaft e suksesshme në mbulimin e fushatave të partive të vogla të cilat i ka paraqitur në mënyrë të balancuar.


Minoritetet *RTK* ka dhënë hapësirë të madhe partive minoritare si në edicionet e lajmeve e ashtu edhe në debate të hapura.

Balanci gjinor *RTK* ka treguar një mbulim jo të kënaqshëm të kandidateve femra në krahasim me televizionet e tjera.

Fokusi individual Hapësira më e madhe i është dhënë Hashim Thaçit ndërsa ajo më e vogla Ramush Haradinajt. Konteksti më pozitiv i është dhënë Hashim Thaçit e po ashtu edhe prezantimi më pozitiv.


Partitë e mëdha

Hapësira më e madhe kohore i është kushtuar PDK-së, përderisa më e vogla LDD-së.



Sekonda


Konteksti



PDK është prezantuar në kontekstin më pozitiv, përderisa LDK në atë më negativ.

Prezantimi


Prezantimi më pozitiv gazetaresk në RTK i është dhënë PDK-së, përderisa ai negativ AAK-së.



Koha

Partitë e vogla

Konteksti i partive të vogla në RTK ishte pozitiv, ndërsa prezantimi ishte neutral.




Sekonda

Koha

Partitë minoritare


Prej partive minoritare koalicioni VAKAT ka marrë kohën më të madhe në RTK, përderisa partia SKMS ka marrë kohën më të vogël në këtë televizion.

Kontekstin më pozitiv prej



Sekonda

Konteksti




Numri i paraqitjeve

partive minoritare në RTK e ka marrë koalicioni VAKAT, ndërsa kontekstin negativ PDAK, SLS dhe SNS. RTK ka treguar një prezantim neutral për partitë minoritare.

Koha


Kandidatët kryesorë

Hapësira më e madhe prej kandidatëve kryesorë në RTK i është dhënë Hashim Thaçi, përderisa më e vogla Ramush Haradinajt.



Sekonda

Konteksti




Numri i paraqitjeve

Kontekstin më pozitiv prej kandidatëve kryesorë në RTK e ka marrë Hashim Thaçi, përderisa atë negativ Behxhet Pacolli.

Monitorimi i mediave (26 tetor – 16 nëntor)

Paraqitja më pozitive prej kandidatëve kryesorë në RTK i është dhënë Hashim Thaçit dhe Behgjet Pacollit. Kandidatët e tjerë, RTK kryesisht i ka paraqitur në mënyrë neutrale, ndërsa asnjërit prej kandidatëve kryesorë nuk i ka dhënë prezantim gazetaresk negativ.




Koha Vision (KTV)

- Hyrje Pronë e grupit medial KOHA. Ka lidhje të ngushta me kreun e ORA-s, Veton Surroin, i cili ishte pronar para krijimit të partisë.
- Vlerësim i përgjithshëm Gjatë fushatës zgjedhore, KTV ka qenë televizioni më kritik ndaj zyrtarëve të koalicionit qeveritar (AAK-LDK). Hapësira më e madhe i është dhënë LDK-së, ORA-s, PDK-së dhe AKR-së ndërsa më e vogla LDD-së. Konteksti më pozitiv i është dhënë PDK-së ndërsa ai më negativ LDK-së. Prezantimi më pozitiv i është dhënë ORA-s, ndërsa ai më negativ LDK-së dhe AAK-së.
- Pro ORA, PDK
- Kundër LDK, AAK, AKR
- Neutral Të gjitha partitë e tjera.
- Partitë e vogla *KTV* i ka dhënë një hapësirë të kënaqshme përfaqësimit të partive të vogla të cilat i ka prezantuar në mënyrë neutrale.
- Minoritetet *KTV* i ka dhënë një hapësirë të kënaqshme përfaqësimit të partive të pakicave të cilat i ka paraqitur në mënyrë neutrale.
- Balanci gjinor *KTV* ka dhënë hapësirën më të madhe kandidatëve femra prej të tri televizioneve. Në përgjithësi dominojnë kandidatet e partisë ORA, Kollçaku dhe Sahatqija.
- Fokusi individual Hapësira më e madhe kohore i është dhënë Behxhet Pacollit ndërsa më së paku Nexhat Dacit. Konteksti më pozitiv i është dhënë Hashim Thaçit ndërsa ai më negativ Behxhet Pacollit. Prezantimi më pozitiv i është dhënë Veton Surroit ndërsa ai më negativ Behxhet Pacollit dhe Fatmir Sejdiut.


Koha

Partitë e mëdha

Kohën më të madhe prej partive të mëdha KTV ia ka dhënë PDK-së dhe ORA-s.




Konteksti




Kontekstin më pozitiv KTV ia ka dhënë PDK-së dhe ORA-s, ndërsa me kontekst më negativ në KTV është paraqitur LDK dhe AAK.

Prezantimi

Prezantimin më pozitiv KTV ia ka dhënë partisë ORA. Me prezantimin më negative gazetaresk KTV e ka paraqitur LDK-në dhe AAK-në.





Koha



Partitë e vogla

Prej partive të vogla KTV kohën më të madhe ia ka dhënë PD-së.

Konteksti i partive të vogla në KTV është pozitiv, derisa prezantimi vogla ishte neutrale.





Partitë minoritare

Kohën më të madhe për partitë minoritare KTV e ka rezervuar për SDA-në, derisa më së paku kohë i ka kushtuar ND-së. Kryesisht, të gjitha partitë minoritare

në KTV janë paraqitur me konteskt pozitiv, përderisa asnjë prej tyre nuk është paraqitur në konteskt negativ. Të gjitha partitë minoritare në KTV janë paraqitur në mënyrë neutrale.

Kandidatët kryesorë

Hapësira më e madhe prej kandidatëve kryesorë në KTV i është dhënë Behgjet Pacollit, përderisa më e vogla Nexhat Dacit. Konteksti më pozitiv prej



kandidatëve kryesorë në KTV i është dhënë Hashim Thaçit, ndërsa ai negativ Behxhet Pacollit. Prezantimi më pozitiv i është bërë Veton Surroit, ndërsa ai negativ Behgjet Pacollit dhe Fatmir Sejdiut.



Radio Televizioni 21 (RTV 21)

Hyrje Radio dhe Televizioni 21 janë pronë e familjes Kelmendi. Televizioni dhe radioja menaxhohen nga Afërdita Saraqini-Kelmendi.

Vlerësim i përgjithshëm *RTV 21* i është përmbajtur kodit të mirësjelljes ndërsa ka paraqitur një gazetari të balancuar dhe zyrtare gjatë mbulimit të fushatave të partive politike. Hapësira më e madhe i është dhënë LDK-së ndërsa më e vogla LDD-së. Konteksti më pozitiv i është dhënë LDK-së ndërsa ai më negativ PDK-së. Prezantimi më pozitiv i është dhënë AKR-së.

Pro Nuk është vërejtur ndonjë anim i theksuar ndaj ndonjë partie.

Kundër Nuk është vërejtur ndonjë gjuhë e urrejtjes ndaj ndonjë partie.

Neutral Të gjitha partitë.

Partitë e vogla Ky televizion ka dhënë një hapësirë të madhe partive të vogla ndërsa ka treguar një gazetari të balancuar gjatë mbulimit të fushatave të tyre


Minoritetet *RTV 21* ka dhënë kohë të konsiderueshme një numri të gjerë të partive minoritare, të cilat i ka paraqitur në kontekst pozitiv dhe prezantim gazetaresk neutral

Balanci gjinor *RTV 21* ka treguar një hapësirë mesatare për kandidatet femra.


Fokusi individual Hapësira më e madhe dhe konteksti më pozitiv i është dhënë Hashim Thaçit ndërsa më e vogla Ramush Haradinajt. Prezantimi më pozitiv i është dhënë Behgjet Pacollit dhe Veton Surroit. *RTV 21* nuk ka paraqitur asnjë udhëheqës në prezantim negativ.

Partitë e mëdha

Koha më e madhe dhënë partive të mëdha në RTV 21 i ka takuar PDK-së, ndërsa koha më e vogël LDD-së.




Konteksti




Konteksti më pozitiv dhënë partive të mëdha në RTV 21 i është dhënë LDK-së, ndërsa konteksti më negativ PDK-së.

Prezantimi

Prezantimi më pozitiv gazetaresk në RTV 21 i është dhënë AKR-së, ORA-s dhe PDK-së.



Koha





Partitë e vogla

Kohën më të madhe në RTV 21 prej partive të vogla e ka marrë PD-ja ndërsa më të voglën BK.

Konteksti

Konteksti për partitë e vogla në RTV21 ka qenë kryesisht pozitiv. Paraqitja gazetareske për partitë e vogla në RTV21 ka qenë neutrale.


Koha



Partitë minoritare
Kohën më të madhe dhënë partive minoritare në TV 21 e ka marrë VAKAT, ndërsa kohën më të vogël PREBK.

Konteksti


Paraqitjen më pozitive të kontekstit për partitë e vogla në RTV 21 e ka marrë SKMS e po ashtu edhe atë më negative. Prezantimi ka qenë neutral për të gjitha partitë.



Kandidatët kryesorë

Prezantimi

Më së shumti hapësirë kohore i është dhënë Hashim Thaçit, i cili është treguar në kontekstin më pozitiv. Prezantimi më pozitiv i është bërë Behxhet Pacollit dhe Veton Surroit. RTV 21 nuk ka paraqitur asnjë udhëheqës në prezantim negativ.




Radio Kosova

- Hyrje Radio publike.
- Vlerësim i përgjithshëm *Radio Kosova* ka shfaqur një gazetari të balancuar dhe neutrale. Hapësira më e madhe i është dhënë LDK-së ndërsa ajo më e vogël LDD-së. Konteksti më pozitiv i është dhënë LDK-së.
- Pro Kjo radio ka treguar qëndrim të lehtë pro-LDK.
- Kundër Asnjë parti.
- Neutral Partitë tjera.
- Partitë e vogla *Radio Kosova* po ashtu ka dhënë një hapësirë mesatare dhe ka treguar një balansim edhe në prezantimin e partive të vogla konkurruese
- Minoritetet Ka shfaqur një gazetari të balancuar, ndërsa ka prezantuar në mënyrë të kënaqshme partitë minoritare.
- Balanci gjinor Kjo radio ka treguar një hapësirë të kënaqshme për kandidatet femra.
- Fokusi individual Hapësira më e madhe i është dhënë Veton Surroit ndërsa ajo më e vogla Ramush Haradinajt. Konteksti më pozitiv i është dhënë Hashim Thaçit.


Koha

Partitë e mëdha

LDK prin në hapësirën e dedikuar në *Radio Kosova*, e cila gjithashtu ka pasur kontekstin dhe prezantimin më pozitiv. *Radio Kosova* nuk ka prezantuar negativisht asnjërën prej partive të mëdha.



Konteksti



Partitë e vogla


Koha më e madhe dhe konteksti më pozitiv dhënë partive të vogla në *Radio Kosova* i është dhënë PD-së, ndërsa koha më e vogël BK-së. *Radio Kosova* nuk e ka paraqitur asnjë parti të vogël në konteskt negativ.

Koha


Prezantimi i saj gazetaresk për partitë e vogla ka qenë neutral.

Partitë minoritare

Koha më e madhe dhënë partive minoritare në *Radio Kosova* i është dhënë





Koha



KDTP-së. Konteksti më pozitiv i partive minoritare në *Radio Kosova* i është dhënë KDTP-së dhe PDAK-së. *Radio Kosova* nuk e ka paraqitur asnjë parti minoritare në konteskt negativ, dhe prezantimi gazetaresk ishte neutral për të gjitha.

Zyrtarët kryesorë

Kohën më të madhe *Radio Kosova* ia ka dhënë Veton Surroit, përderisa kohën më të vogël Ramush Haradinajt.



Konteksti më pozitiv i është dhënë Hashim Thaçit. Prezantimi gazetaresk i kandidatëve kryesorë në *Radio Kosova* ka qenë neutral.


Radio Dukagjini

- Hyrje Radio Dukagjini është pjesë e kompanisë Dukagjini pronar i së cilës është Ekrem Lluka.
- Vlerësim i përgjithshëm *Radio Dukagjini* ka treguar një mbulim të balancuar të fushatave të partive politike duke tentuar që t'u japë të gjitha subjekteve kohën e njejtë të prezantimit të programit të tyre politik. Koha më e madhe i është dhënë LDK-së ndërsa më e vogla LDD-së. Konteksti më pozitiv i është dhënë PDK-së ndërsa më negativ LDK-së.
- Pro Nuk është vërejtur asnjë tendencë animi.
- Kundër Nuk është vërejtur asnjë tendencë për gjuhë urrejtjeje ndaj ndonjë subjekti politik.
- Neutral Të gjitha partitë.
- Partitë e vogla Kjo radio ka dhënë një hapësirë mesatare për partitë e vogla duke i prezantuar ato në mënyrë të balancuar
- Minoritetet *Radio Dukagjini* ka treguar një mbulim jo të mirë të partive minoritare në aspektin kuantitativ.
- Balanci gjinor Paraqitje e varfër e femrave kandidate.
- Fokusi individual Koha më e madhe i është dhënë Hashim Thaçit ndërsa më e vogla Ramush Haradinajt. Hashim Thaçi ka marrë prezantimin më pozitiv në *Radio Dukagjini*.

Koha


Partitë e mëdha

Koha më e madhe dhënë partive të mëdha në *Radio Dukagjini* i është dhënë LDK-së ndërsa koha më e vogël LDD-së.



Sekonda

Konteksti




Konteskti më pozitiv i partive të mëdha në *Radio Dukagjini* i është dhënë PDK-së, ndërsa në konteskt negativ është paraqitur LDK-ja dhe AKR-ja. Prezantimi gazetaresk gjithashtu ka qenë më pozitiv për PDK-në.

Koha

Partitë e vogla


Koha më e madhe dhënë partive të vogla në *Radio Dukagjini* i është dhënë PD-së, derisa koha më e vogël i është dhënë BK-së. Paraqitja e kontekstit të partive të vogla në *Radio Dukagjini* ka qenë pozitive ndërsa prezantimi neutral.



Sekonda

Partitë minoritare

Koha më e madhe dedikuar partive minoritare në *Radio Dukagjini* i është dhënë ND-së derisa ajo më e vogla SLS-së. Paraqitja e kontekstit për partitë minoritare ka qenë pozitive dhe prezantimi neutral.




Koha

Sekonda


Zyrtarët kryesorë

Koha më e madhe për kandidatët kryesorë të partive të mëdha në *Radio Dukagjini* i është dhënë Hashim Thaçit, ndërsa koha më e vogël Ramush Haradinajt. Paraqitja e kontekstit për kandidatët kryesorë në *Radio Dukagjini* është pozitive. Prezantimi i kandidatëve kryesorë është neutral. Hashim Thaçi ka marrë prezantimin më pozitiv.



Prezantimi gjinor


Prezantimi i balancit gjinor në mediat e shtypura tregon se *Epoka e re* dhe *Info Press* kanë dhënë hapësirën më të madhe kandidateve femra, ndërsa



Hapësira

cm2

Sekonda



Koha

gazeta *Lajm* ka dhënë hapësirën më të vogël.

Nga televizionet kombëtare, *KTV* ka dhënë hapësirën më të madhe kandidateve femra, 7.1% të paraqitjes së subjekteve politike, në krahasim me 6% *RTV21* dhe 2.4% në *RTK*. Mirëpo, radioja publike ishte më korrekte ndaj femrave (9.7%) sesa *Radio Dukagjini* (6.2%).


Partitë e vogla

Si në gazeta, edhe në televizione dhe radio, Partia e Drejtësisë ka pasur hapësirën më të madhe nga partitë e vogla, si dhe kontekstin dhe prezantimin më pozitiv. Balli Kombëtar dhe LKÇK-ja kanë marrë eksponim medial në kontekst negativ dhe paraqitje gazetareske negative prej disa nga mediat.

PD-ja ka marrë më së shumti hapësirë në gazetën *Lajm* ndërsa më së paku në gazetën *Express*. LKÇK-ja ka marrë më së shumti hapësirë në gazetën *Zëri* ndërsa më së paku në gazetën *Express*. BK-ja më së shumti ka marrë hapësirë në gazetën *Koha Ditore* dhe *Zëri* ndërsa më së paku në gazetën *Express* dhe *Info Press*.

I njëjti trend ka përcjell edhe raportimin për këto subjekte në tri televizionet dhe në dy radiot e monitoruara, PD-ja prin, pastaj LKÇK-ja dhe BK-ja. PD-ja ka marrë më së shumti kohë në *RTK* ndërsa më së paku në *KTV*. LKÇK-ja ka marrë kohën më të madhe në *RTK* ndërsa më së paku


Prezantimi gjinor



në KTV. BK-ja ka marrë kohën më të madhe në RTK ndërsa atë më të vogël në RTV 21. Secila prej partive të vogla ka marrë kohë më shumë në Radio Kosova sesa në Radio Dukagjini.

Partitë e pakicave


Nga partitë e pakicave dallohen për vëmendje ajo



1000 cm2

Partitë minoritare

turke (KDTP), boshnjake (VAKAT, SDA), rome (PREBK) dhe partia e ashkallive, (PDAK). Partitë minoritare kryesisht janë paraqitur në kontekst pozitiv derisa paraqitja e tyre gazetareske është neutrale. Në veçanti, edhe partitë minoritare serbe janë paraqitur në




kontekst pozitiv, derisa paraqitja gazetareske e tyre ka qenë neutrale në të shumtën e kohës.


PDAK, PREBK, IRDK dhe SDA kanë pasur hapësirën më të madhe në *Koha Ditore*, KDTP në *Zëri*, VAKAT në *Info Press*.

RTK u ka dhënë më së shumti hapësirë partive

të të gjitha pakicave në krahasim me televizionet tjera kombëtare. Nga dy të tjerat, VAKAT paraqitet më tepër në TV21, ashtu si edhe SDA, KDTP, IRDK, edhe PDAK. Vetëm PREBK ka pasur më tepër hapësirë në KTV sesa në TV21.

Nga televizionet kombëtare partive serbe më së shumti hapësirë i ka dhënë RTV 21 ndërsa më së paku KTV. Hapësirën më të madhe partive serbe i ka dhënë *Koha Ditore*, *Epoka e re* dhe *Zëri*. Gazeta *Lajm* nuk ka pasur paraqitje të partive serbe.






Zyrtarët kryesorë


Nga koha dhe hapësira që kanë marrë në media, prej zyrtarëve kryesorë prijnë Hashim Thaçi dhe Behgjet Pacolli. Kreu i AKR-së, Pacolli zë vendin e parë si zyrtari kryesor me kontekst negativ dhe paraqitje negative gazetareske në media. Nga zyrtarët kryesorë, më së paku hapësirë i është dhënë Nexhat Dacit dhe Ramush Haradinajt.

Partitë e mëdha

Për nga hapësira, PDK ka pasur më së shumti në *Info Press*, pasuar nga *Epoka e Re*, dhe *Koha Ditore*. LDK është mbuluar më së shumti nga *Zëri* (i vetmi medium në të cilin prin për nga mbulueshmëria), pasura nga *Koha Ditore* (ku është mbulura përafërsisht sa AAK). AKR është mbuluar më së shumti nga *Lajmi*, pasuar nga *Epoka e Re*. ORA ishte subjekti i dytë për *Kohën Ditore*, nga e cila është mbuluar më së shumti.



Monitorimi i mediave (26 tetor – 16 nëntor)



ORA ishte subjekti i dytë më i mbuluar në KTV, përderisa në RTK dhe TV21 ishte më së paku tok me LDD-në. LDD ishte gjithashtu dobët e mbuluar nga KTV. AAK ishte subjekti i dytë më i mbuluar nga RTK.

Në radiot kombëtare, LDK ishte mbuluar më tepër, pasura nga PDK, AAK, ORA, AKR dhe LDD, në këtë radhitje. *Radio Kosova* ju ka kushtuar më tepër hapësirë partive, përderisa *Radio Dukagjini* u ka dhënë të gjithë subjekteve më pak hapësirë.

